



## Origjinat e Modernitetit – Miti i ngritjes se perendimit

### Description

Robert B. Marks

Fragment i shkëputur nga libri i autorit Robert B. Marks me titull: *The Origins of the Modern World: A Global and Environmental Narrative from the Fifteenth to the Twenty-First Century* (Rowman & Littlefield Publishers, 2015), fq. 1-19.

Përktheu: Arjol Guni

20-22 KORRIK, 2001; Gjenovë, Itali. Udhëheqësit e vendeve më të të industrializuara në botë – të njohur si Grupi me Shtatë, apo G7 – u takua në korrik të vitit 2001 në këtë qytet-port të Mesdheut për të diskutuar mbi ekonominë botërore. G7-ja deklaroi se “rritja e qëndrueshme ekonomike në mbarë botën kërkon një angazhim të ripërtërirë për tregti të lirë [globale]... Hapja e tregjeve nga pikëpjmja globale dhe fuqizimi i Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) si themeli i tregtisë shumëpalëshe është ... një domosdoshmëri ekonomike.”<sup>[1]</sup> Takimi G7-ës, njëlloj si takimi i vitit 1999 i OBT-së në Siatëll, tërhoqi mijëra njerëz që i kundërviheshin si takimit ashtu dhe objektivave të tij. Dhe vërtet, gjatë atyre tri ditëve të korrikut, 100,000 protestues kundër “globalizmit” erdhën në Gjenovë, shumica për të mbajtur kundërmitingje dhe për të nxjerrë në pah pabarazitë në ekonominë globale, por mijëra të tjerë marshuan gjithashtu, dhe një numër i konsiderueshëm njerëzish thyen dyqane dhe u ndeshën me policinë, qindra u arrestuan, dhe një njeri mbeti i vrarë.

Ne e nisim këtë histori të shkurtër të origjinës së botës moderne me një ngjarje të kohëve të fundit për shkak se takimet e G7-ës – të cilat janë mbajtur gjatë njëzet e pesë viteve të fundit dhe do të vazhdojnë të mbahen në të ardhmen e parashikueshme – shpalosin shumëçka në lidhje me natyrën e botës ku ne jetojmë dhe ngrajnë disa pyetje mjaft interesante historike në lidhje me atë se si bota jonë e globalizuar u bë e tillë siç është sot. Le të marrim fillimisht përshkrimin e G7-ës si “vendet më të mëdha të industrializuara”. Ky formulim tregon se bota sot përbëhet nga njësi politike sovraane të quajtura “vende”, dhe se ato vende të G7-ës janë të industrializuara. Dhe vërtet, vendet e G7-ës përbëjnë dy të tretat e të gjithë prodhimit dhe pasurisë ekonomike botërore. Me nënkuptim, pjesa tjetër e botës është më e varfër dhe më pak e industrializuar, në qoftë se është e tillë.

Kur vendoset në një kontekst të gjerë historik, ky fakt i G7-ës është jashtëzakonisht interesant dhe ngre pyetje të thella. Vetëm 200 vjet më parë, dy vendet të tjera – India dhe Kina – përbënin dy të tretat e prodhimit të ekonomisë së botës, dhe ato nuk janë vende evropiane. Në hapësirën e vetëm 200 viteve, bota ka parë një përmbysje të madhe të fatit: atje ku dikur aziatikët mbanin pjesën më të madhe të kartave ekonomike, sot ato mbahen kryesisht nga vendet perëndimore dhe Japonia. Pyetja e parë silltet rreth asaj se si ndodhi kjo. Si erdhën dhe përkufizuan botën tonë vendet e industrializuara dhe të stilit European – dhe jo perandoritë tej mase të zhvilluara agrare të Kinës dhe Indisë?

Së dyti, ndër çështjet e axhendës së G7-ës ishte çfarë të bëhej në lidhje me hendekun në rritje ndërmjet viseve më të pasura dhe atyre më të varfëra të botës, në qoftë se do të bëhej diçka, ku këto të fundit ndodheshin kryesisht në Azi, Afrikë, dhe Amerikë Latine. Njëlloj si industrializimi, shtetet kombe dhe dominanca perëndimore, edhe ky hendek, gjithashtu, është shfaqur gjatë dyqind viteve të fundit. Si dhe përse pjesë të mëdha të botës dhe njerëz që banojnë në të janë të dënuar me një varfëri në rritje është gjithashtu një çështje e rëndësishme që trajtohet këtu, siç është pyetja a janë bërë disa vende të botës të pasura vetëm në kurriz të varfërimit të pjesëve të tjera.

Së treti, industrializimi i ka dhënë fuqi të madhe vendeve të G7-ës, kaq të madhe sa që udhëheqësit e tyre mund të takohen për të përcaktuar rregullat se si të funksionojë ekonomia botërore. Sigurisht, kjo është një nga arsyet parësore të protestave kundër G7-ës, OBT-së, dhe institucioneve të tjera financiare (siç janë Fondi Monetar Ndërkombëtar [FMN]). Protestuesit, në fakt, po pyesin: “Si ka mundësi që i vendosni ju rregullat?” Dhe kërkojnë që të bëhen organizime të tjera globale.<sup>[2]</sup> Pavarësisht nga kjo, janë udhëheqësit e botës së industrializuar ata që i bëjnë rregullat, një fuqi kjo që ushtrohet pjesërisht për të siguruar vijueshmërinë e pasurisë dhe pushtetit të botës së industrializuar. Ndonëse ky pushtet ushtrohet kryesisht nëpërmjet tregtisë globale dhe institucioneve financiare si OBT-ja dhe FMN-ja, ai mbështetet nga një fuqi ushtarake e qenësishme, ndonjëherë e vringëlluar në mënyrë të njëanshme nga vendet e G7-ës (siç është rasti i Shteteve të Bashkuara) por gjithashtu edhe nga aleancat si Organizata Aleanca e Atlantikut Verior (NATO). Kur vendoset në një perspektivë historike, kjo fuqi është jashtëzakonisht interesante, pasi perëndimorët nuk e kanë pasur për një kohë shumë të gjatë këtë fuqi.

Në këtë mënyrë, për të kuptuar botën tonë ne duhet të kuptojmë jo thjesht se si shtetet kombe (“vendet” në deklaratën e G7-ës) dhe industria filluan të formësonin botën moderne, por se si dhe përse ato mënyra evropiane të organizimit të botës filluan të dominonin globin. Shpjegime ka plot, por për pjesën më të madhe të dy shekujve të kaluar, shpjegimi mbizotërues në Perëndim, përfshirë dhe Shtetet e Bashkuara, ka qenë “ngritja e Perëndimit”. Sikundër kemi për ta parë, kërkimet e kohëve të fundit kanë treguar se ky shpjegim nuk është bindës tashmë, por për shkak se ai është sipas të gjitha gjasave shpjegimi me të cilin pjesa më e madhe e lexuesve janë të familjarizuar, unë do të harxhoj këtu disa fletë për ta eksploruar dhe për të nxjerrë në pahë disa prej të metave të tij.

## **Ngritja e Perëndimit**

Koncepti i ngritjes së Perëndimit ofron një arsyetim dhe një rrëfim që orvatet të shpjegojë jo vetëm botën moderne, por edhe përse ajo përkufizohet nga tipare pikë së pari evropiane. Ideja që shtrihet pas saj është mjaft e thjeshtë dhe filloi të ngrinte kryet fill pas pushtimit spanjoll të Amerikave, gjatë Rënesansës italiane të shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Europeanët ngelën mjaft të habitur kur panë qindra konkuistadorë spanjollë të shuanin nga faqja e dheut disa civilizime amerikane të mëdha dhe mjaft të pasura, në veçanti aztekët dhe inkasit. Duke qenë të paditur në lidhje me teorinë e mikrobeve

për sëmudjet dhe shkakun e “Vdekjes së Madhe” në Meksikë, ku pothuajse 90 përqind e popullsisë së Meksikës qendrore prej tridhjetë milionë njerëzish humbi jetën si pasojë e sëmudjeve evropiane si lia e dhurve dhe gripi, evropianët fillimisht ia atribuuan superioritetin e tyre fesë së tyre të krishterë. Më vonë, gjatë Iluminizmit të shekullit të shtatëmbëdhjetë dhe atij të tetëmbëdhjetë, ata ia atribuuan epërsinë e tyre trashëgimisë greke të lashtë të mendimit sekular, racionalist, dhe shkencor.

Në fund të viteve 1700 ky rrëfim vazhdon: si Revolucioni Industrial ashtu dhe Revolucioni Francez i vitit 1789 përforcoi vetëdijen në mendjet evropiane jo thjesht se ishin të ndryshëm nga pjesa tjetër e botës, por gjithashtu se evropianët po “bënin progres” me shpejtësi ndërkohë që pjesa tjetër e botës dukej se ishte në stanjacion, se evropianët ishin disi të jashtëzakonshëm – madje edhe më të mirë – se sa pjesa tjetër e botës. Historianët evropianë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, të impresionuar me atë që shumë e cilësonin se ishte joshja idealeve të Revolucionit Francez – *égalité, liberté, fraternité* (barazi, liri dhe vëllazëri) – e hodhën vështrimin pas te grekët e lashtë, tek institucionet e tyre të demokracisë dhe të republikës, dhe te prirja e tyre racionaliste për të kuptuar botën natyrore në terma shkencore, e jo fetarë. Në këtë tregim të hershëm të “ngritjes së Perëndimit”, rrëfimi është i ngjashëm me një garë me stafeta, me idetë e demokracisë që lindën në Greqi, iu kaluan romakëve, të cilëve stafeta iu ra nga duart (rënia e Perandorisë Romake e ndjekur nga e ashtuquajtura Mesjetë e Errët), por më pas Krishterimi hyri në skenë për ta marrë atë dhe për të vrapuar me atë, duke krijuar një kulturë të dallueshme evropiane gjatë kohërave feudale. Trashëgimia greke e lashtë u zbulua rishtazi gjatë Rënesansës (“Rilindjes evropiane”), u elaborua gjatë Iluminizmit, dhe përfundimisht u përmbush në Revolucionin Francez dhe atë amerikan dhe në “ngritjen e Perëndimit.”

Në qoftë se perëndimi ishte në proces “ngritjeje” gjatë shekullit të tetëmbëdhjetë, gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë dalja e tij në pah kishte përfunduar. Teksa Revolucioni Industrial i fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë dhe fillimit të shekullit të nëntëmbëdhjetë sa po fillonte, ekonomistët politikë britanikë klasikë – Adam Smith, Thomas Malthus, dhe David Ricardo – zhvilluan një tjetër fill që do të thirrej në historinë e ngritjes së Perëndimit: idetë e zhvillimit kapitalist si “progres”, Perëndimin si “progresiv”, dhe Azinë (dhe me nënkuptim, Afrikën dhe Amerikën Latine gjithashtu) si “prapanike” dhe “despotike”. Një gjë është e sigurtë, kontrastet ndërmjet virtyteve të Perëndimit dhe të metave të Lindjes – Orientit – mund të kenë datuar te grekët e lashtë, por evropianët e shekullit të tetëmbëdhjetë kishin ngelur të impresionuar nga pasuria dhe qeverisja e vendeve aziatike, sidomos nga Kina. Teksa hapi i ndryshimit ekonomik u përshpejtua në Europën e shekullit të nëntëmbëdhjetë, ndërkohë që një pjesë e madhe e Azisë ishte në një tatëpjetë të brendshme, analistë si Smith dhe Malthus filluan ta vështronin Perëndimin si dinamik, me vështrimin përpara, progresiv, dhe të lirë, dhe Azinë si në stanjacion, prapanike, dhe despotike.

Madje edhe Karls Marksi dhe Fridrih Engelsi, kritikët më të fuqishëm të rendit të ri botëror kapitalist, besonin se ekspansionizmi evropian i shekullit të nëntëmbëdhjetë po sillte “progres” në pjesën tjetër të botës. Në *Manifestin Komunist*, të botuar fillimisht në vitin 1848, ata shkruanin:

Borgjezia [europiane], me anë të përmirësimit të shpejtë të mjeteve të prodhimit, me anë të mjeteve jashtëzakonisht të lehtësuara të komunikacionit, i vë në rrugën e civilizimit edhe kombet më prapanike. Çmimet e ulëta të mallrave të saj janë artileria e rëndë, me anën e së cilës ajo rrëzon në tokë të gjitha muret kineze, dhe me të cilat e bën që të kapitulojë urrejtja e fortë dhe kryeneçe e vendeve të pazhvilluara kundrejt të huajve. Ajo i shtrëngon të gjitha kombet, nën kërcënimin e zhdukjes, që të pranojnë mënyrën borgjeze të prodhimit; i shtrëngon ato të fusin në mesin e tyre atë që ajo e quan civilizim, pra, të bëhen edhe ata borgjezë. Me një fjalë, ajo krijon një botë sipas shëmbëlltyrës së saj.<sup>[3]</sup>

Megjithatë, një rëndësi më të madhe për konceptualizimet perëndimore të historisë së tyre ka patur Maks Veberi, një sociolog gjerman i cili ka shkruar aty nga kapërcyelli i shekullit të njëzet. Ndërkohë që Veberi kishte të përbashkët me Marks sin një magjepsje me shpjegimin se si dhe përse kapitalizmi u zhvillua në Europë – dhe vetëm në Europë – Veberi ndahej nga Marksi në formulimin e këtij shpjegimi. Në vend se të fokusohet në llojet si Marksi mbi shpjegimet “materialiste”, Veberi i shikonte ato aspekte të vlerave dhe kulturës perëndimore, në veçanti racionalizmin dhe etikën e punës që ai e bashkëlidhte me Protestantizmin, si vendimtare për ngritjen e kapitalizmit. Por në vend se ta bazonte idenë e tij në lidhje me ngritjen e Perëndimit thjesht e vetëm mbi studimet e Perëndimit, Veberi faktikisht kreu hulumtime mbi shoqëritë kineze dhe indiane, i krahasoi ato me Europën, dhe doli në përfundimin se, të paktën, këtyre dy shoqërive dhe me nënkuptim të gjitha shoqërive të tjera jo-europiane, u mungonin vlerat kulturore që janë të domosdoshme për kapitalizmin. Pavarësisht nga kjo, edhe ato mund të “modernizoheshin”, mendonte Veberi, por vetëm duke kaluar nëpër një proces të dhimbshëm të ndryshimit kulturor, duke flakur tutje “pengesat” e tyre kulturore drejt zhvillimit kapitalist.

### **“Hendeku” dhe shpjegimet e tij**

Që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, pra, teoricienët socialë evropianë kanë qenë të vetëdijshëm për një hendek në rritje ndërmjet vendeve të industrializuara dhe pjesës tjetër të botës. Duke besuar se evropianët perëndimore – dhe vetëm ata – i kishin gjetur kyçin sekretit të modernizimit,<sup>[4]</sup> dhe se edhe të tjerët gjithashtu mund të mësonin prej tyre, ithtarët e Smithit, Marksit dhe Veberit në shekullin e njëzet kanë parashtruar një teori “difuzioniste” (përhapëse) rreth asaj se si është shpalosur historia botërore. Evropianët zbuluan se si të bëheshin të pasur fillimisht duke u industrializuar, Japonia dhe disa pak vende të tjera mësuuan nga evropianët dhe i kanë arritur ata, dhe përfundimisht edhe çdo vend tjetër në glob ka për të bërë të njëjtën gjë, për sa kohë që ata identifikojnë dhe eliminojnë institucionet lokale dhe tiparet kulturore që i pengojnë ata që të bëhen modernë.

Parë tani nga fillimi i shekullit të njëzet e një, këto ide duket se janë mjaft jobindëse, sidomos në dritë të faktit se hendeku ndërmjet pjesëve më të pasura dhe atyre më të varfëra të botës vijon të rritet, jo të tkurret, sikundër do të donte që të besonim teoria “difuzioniste”. Megjithatë, është i rëndësishëm fakti se këta teoricienë evropianë të shekullit të tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë – Smith, Malthus, Ricardo, Marks dhe Veber – të gjithë pranonin idenë e eksepcionalizmit (veçanësisë) evropian dhe kërkonin, si një nga qëllimet e tyre kryesore intelektuale, që ta shpjegonin atë. Këta njerëz ishin themeluesit e teorisë moderne të shkencës sociale, dhe në shekullin e njëzet praktikisht të gjitha shkencat sociale, në veçanti sociologjia dhe ekonomia, kanë trupëzuar idenë e eksepcionalizmit evropian në presupozimet e tyre themelore. Sikundër historianët janë orvatur që të bëhen më tepër “shkencorë” në shekullin e njëzet duke adoptuar dhe përshtatur kuptimet e kësaj shkence sociale ndaj hulumtimit historik, ata gjithashtu u bënë të magjepsur nga kërkimi për origjinat dhe shkaqet e

eksepcionalizmit evropian. Por sikundër kemi për ta parë, evropianët nuk ishin të veçantë, dhe njëra nga pikat më të rëndësishme në lidhje me historinë e botës aty rreth vitit 18000 është krahasueshmëria e përgjithshme e Azisë me Europën. Pavarësisht nga kjo, kërkimi për përgjigje ndaj asaj se “përse” evropianët perceptoheshin si të veçantë dhe, prej kësaj, përfundimisht superiorë vijon të buisë në mesin e historianëve sot e kësaj dite, ndonëse të shumtë janë ata që sot mund të mos mendojnë se kjo është një pyetje e gabuar.

Në epokën pas Luftës së Dytë Botërore, ky kërkim ka prodhuar një korpus mbresëlënës të studimeve akademike që janë në kërkim të çelësit të asaj që një historian ekonomik e ka quajtur “mrekullia europiane”.<sup>[5]</sup> Këta akademikë fillojnë me atë që ata e shohin si fakti i ngritjes së Perëndimit, por propozojnë zgjidhje të ndryshme ndaj pyetjeve se kur dhe përse filluan “ngritja” dhe “mrekullia”. Pyetja “kur” do të diskutohet e para, duke qenë se në shumë mënyra ajo është relevante për konsideratat e pyetjes “kur”.

Adam Smithi e pa vitin 1492 dhe vitin 1498 (udhëtimet e Kolombit drejt Amerikave dhe Vasko de Gamës përreth Afrikës dhe Indisë respektivisht) si ngjarjet më domethënëse në histori. Sikundër ka shkruar Smith në *Pasurinë e Kombeve* (1776): “Zbulimi i Amerikës, dhe ai i kalimit drejt Indive Lindore nga Kepi i Shpresës së Mirë, janë dy ngjarjet më të mëdha të regjistruara në historinë e njerëzimit.”

Edhe Karl Marksi këto data i shihte si vendimtare, sikundër i kanë parë edhe disa akademikë e studiues të shekullit të njëzet që kanë zhvilluar punën e tyre në vazhden e traditës marksiste, të cilët e kanë drejtuar gishtin te kolonializmi i mëvonshëm evropian, skllavëria, dhe shfrytëzimi i kolonive në Amerikë dhe në Azi si shpjegimet kryesore për ngritjen e Perëndimit. Shumë jo-marksistë e kanë kontestuar idenë se ngritja e Europës ishte një rezultat i shfrytëzimit të të tjerëve,<sup>[6]</sup> një fakt i pavolitshëm dhe aspak i pakëndshëm në qoftë se është i vërtetë, dhe në vend të kësaj e kanë kthyer vëmendjen e tyre drejt atyre aspekteve të kulturës europiane që datojnë përpara kolonializmit evropian, duke filluar me pushtimin spanjoll të Botës së Re.

Për të shmangur sikletin e mundshëm me të mveshurit e ngritjes së Perëndimit sipërmarrjeve të tij koloniale, dhe jo vrityteve të tij të qenësishme, një pjesë e madhe e akademizmit të pas Luftës së Dytë Botërore mbi origjinën e ngritjes së Perëndimit e ka hedhur vështtrimin shumë më pas në historinë europiane, në disa raste deri në Mesjetë në shekujt e njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë, ose akoma edhe më herët deri te grekët e lashtë, për faktorë që mund t'i atribuoheshin vetëm zhvillimit të jashtëzakonshëm të vetë Europës. Faktorët që janë identifikuar, krahas vlerave kulturore të diskutuara nga Veber, përfshijnë faktorët mjedisorë (klimat e buta promovojnë punë të palodhur, ose dheu i varfër nxit risinë agrikuturore), ata teknologjikë (pamendën, yzengjitë, ose xhamat për lexim), ata politiko-ushtarakë (feudalizmi që ka çuar drejt monarkëve absolutë dhe më pas shtetet kombe dhe teknologjia evoluese e luftës), ato demografike (familjet e vogla promovojnë grumbullimin e kapitalit), dhe në mendjet e disa historianëve, kombinimet e të gjitha apo disa prej këtyre që përmendëm.<sup>[7]</sup>

Implikimi i këti korpusi të punimeve akademike është se Europa ka zotëruar disa karakteristika unike që i kanë lejuar asaj – dhe vetëm asaj – që fillimisht të modernizohet, dhe më pas i dhanë asaj autoritetin moral dhe fuqinë për të përhapur “modernitetin” në mbarë globin ku “pengesat” kulturore, politike, apo ekonomike parandaluan që zhvillimi modern të ndodhte sipas mënyrës autoktone. Prandaj, ky rrëfim synon që të shpjegojë, justifikojë, dhe mbrojë ngritjen e Perëndimit në dominancë globale. Se sa kryekëput e gabuar është kjo teori, do të bëhet më e qartë teksa, në rrjedhën e këtij libri, do të shpaloset epërsia industriale e pjesës më të madhe të Azisë ndaj asaj të Europës, të paktën

përpara vitit 1750.

Përpara se t'i kthehemi pyetjes përse ka rëndësi e gjitha kjo, lejomëni fillimisht që të them disa pak fjalë në lidhje me njësitë gjeografike të përdorura në këtë libër. Në paragrafin e mësipërm, unë përmend një krahasim ndërmjet “Azisë” dhe “Europës”, duke nënkuptuar se këto njësi janë të krahasueshme dhe gjithashtu se ato kanë një lloj uniteti që i dallon ato nga njëra tjetra. Ky supozim është problematik, kryesisht për Azinë, për shkak të larmisë së gjerë të shoqërive që gjenden në gjirin e saj, me një gamë që nga Kina dhe Japonia në Azinë Lindore, përfshirë popujt nomadë në Azinë Qendrore, e deri në Indi në jug, dhe në Azinë Perëndimore myslimane (Lindja e Mesme). Madje edhe Europa ka pak koherencë në qoftë se ajo merret se përfshin gjithçka nga Portugalia deri në Rusi. Krahas kësaj, deri së voni në historinë tonë (të paktën deri në vitin 1850 ose rreth kësaj kohe), Azia kishte rreth dy të tretat e popullsisë së botës dhe ishte më e gjerë se Europa praktikisht në çdo aspekt. Në këtë drejtim, Europa dhe Azia nuk ishin të krahasueshme. Për më tepër, njëri nga argumentet më të rëndësishme që unë paraqes në këtë libër është se të kuptuarit e origjinave të botës moderne lyp që të ndërmerret një këndvështrim global, fillimisht se si kontinenti i gjerë i Eurazisë, i çiftuar me Afrikën, janë ndërlidhur, dhe më pas mbas vitit 1500, se si Bota e Re iu përshtat kësaj historie. Në fund, madje edhe termat gjeografikë, “Kina”, “India”, dhe “Anglia” apo “Franca” fshehin një laryshi të madhe brenda kufijve të tyre – popuj të ndryshëm, gjuhë apo dialekte të shumta, dhe diferenca të mëdha në pasuri dhe pushtet. Megjithatë, unë do të përdor këto terma gjeografikë për të fillur gjetjen e vendndodhjes së kësaj historie, por lexuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se përgjithësimet e bazuara mbi njësi të gjera gjeografike nuk do të jenë të vërteta në të gjitha kohërat dhe hapësirat e këtyre vendeve që përmendim, dhe se në realitet ajo që ka qenë vërtet e krahasueshme ka ndodhur në pjesë të Kinës, pjesë të Anglisë, apo Hollandës, dhe pjesë të Indisë.

Lexuesit ndoshta vrasin mendjen se përse ka rëndësi çështja e ngritjes së Perëndimit. Dhe s'e kanë keq, përse do studiuar historia fundja fundit? Përgjigja e përmbledhur është sepse kuptimet tonat rreth të shkuarës – cilët jemi, prej nga kemi ardhur, përse jemi këtu ku jemi – i japin trajtë përkufizimeve tona se cilët jemi ne në të tashmen dhe kanë nënkuptime dhe zbatim real për veprimet që ne ndërmarrim, apo që ndërmerren në emrin tonë, për t'i dhënë formë të ardhmes. Idetë e zhvilluara nga historia e ngritjes së Perëndimit për të shpjeguar natyrën e botës ku ne rrojmë, sidomos vlerat e kapitalizmit të tregut dhe institucioneve demokratike, mendohen se kanë zënë fill në mënyrë unike brenda civilizimit perëndimor, e megjithatë kanë zbatueshmëri universale – se janë “të mira” jo vetëm për Perëndimin, por për këdo. Në vijim të këtij presupozimi, zgjidhja praktikisht për të gjitha problemet me të cilat përballet bota sot, të paktën sipas liderëve politikë të Shteteve të Bashkuara dhe atyre evropiane (p.sh., G7), është adoptimi i tregjeve të lira.<sup>[8]</sup> Kështu, Ruisë mbas kolapsit të Bashkimit Sovjetik, udhëheqësve komunistë të Kinës, udhëheqësve të Meksikës, Nigerisë, dhe Indonezisë, liderët perëndimorë u kanë thënë se përgjigja ndaj çdonjërit dhe të gjitha problemeve me të cilat ata përballen është “Më tepër demokraci dhe më tepër tregje të lira”. Ideja është se institucionet dhe vlerat që supozohet se nxitën ngritjen e Perëndimit janë universale, dhe mundet – ç'është e vërteta duhet – që të adoptohen në mbarë botën. Kjo është një axhendë politike.

Po sikur kjo mënyrë e të vështruarit të botës moderne – ngritjes së Perëndimit dhe përhapjes së sistemit të tij mbi bazën e superioritetit të supozuar kulturor ndaj pjesës tjetër të botës – të jetë e gabuar? Kjo është mundësia që ka ngritur një korpus i tërë i studimeve akademike, sidomos gjatë njëzet viteve të fundit.

Jo të gjithë historianët e figurizojnë sërish botën si thjesht një vazhdimësi të tendencave universale dhe

të domosdoshme që filluan shekuj më parë në Europë. Ajo që shumë po shikojnë, në fakt, është një botë në të cilën popullsia, industria, dhe prodhueshmëria bujqësore ishin të përqendruara në Azi deri në vitin 1750 ose 1800. Bota europiane e kapitalizmit industrial dhe shteteve kombe është kësodore mjaft e vonë si edhe një përmbysje – se për sa kohë, megjithatë, kjo mbetet pyetja e madhe që lyp një përgjigje – të tendencave historike afatgjata që favorizonin Azinë. Europeanët mund të kenë pikturuar një tablo të ngritjes së Perëndimit mbi këtë kornizë origjinale, por motivet e fuqisë dhe vitalitetit ekonomik aziatik po fillojnë të shfaqen sërish. Artistët e quajnë konceptin e një njeriu që pikturon mbi një pikturë origjinale ose pjesë të saj si *pentimento*. Siç ka për qëllim të tregojë ky libër, sa më tepër që ne e vështrojmë botën dhe të kaluarën e saj nëpërmjet një drite të re, tablotë e paraqitura në mendjet tona nga ngritja e Perëndimit do të zbulojnë një tjetër motiv, mjaft të ndryshëm, që qëndron në themel të kësaj. Megjithatë, për ta parë atë, ne do të duhet të fillojmë të zhvishemi nga perspektivat tona eurocentrike.<sup>[9]</sup>

## Eurocentrizmi

Një kritik ka thënë se ideja që “Perëndimi ka njëfarë avantazhi historik unik, njëfarë cilësie të veçantë të racës apo kulturës apo mjedisit apo mendjes apo frymës, që i ka dhënë këtij komuniteti njerëzor një epërsi të përhershme mbi të gjitha komunitetet e tjera” është një mit – miti i Eurocentrizmit.<sup>[10]</sup> Një tjetër kritik e ka parë eurocentrizmin si një ideologji, apo një shtrembërim të të vërtetës, e përdorur nga Perëndimi për të maskuar dominancën e tij globale,<sup>[11]</sup> ndërsa një tjetër akoma e cilëson atë një “model teorik”, pra njëri shpjegim në mesin e disa shpjegimeve për atë se si funksionon bota.<sup>[12]</sup> Në këtë nënkapitull, ne do të shqyrtojmë dy aspekte të asaj që kritikët e quajnë eurocentrizëm: së pari, çfarë është ai; dhe së dyti, masën në të cilën ai mund të shihet si i gabuar, si një mit, një ideologji, një teori, apo një narrativë qendrore (master narrative).

Thelbi i eurocentrizmit, sipas kritikëve, nuk është thjesht se ai e sheh historinë nga një këndvështrim europian (pjesa e “centrizmit”) – nuk është vetëm një nga shumë këndvështrimet etnocentrike të botës. Një perspektivë thjesht etnocentrike e pranon se ka shumë popuj dhe kultura të ndryshme në botë, por se kultura ime është më e mirë *për shkak* se ajo buron nga populli dhe kultura ime. Ata janë të mitë, janë më të mirë, nuk janë tuajët. Po ashtu, eurocentrizmi thekson epërsinë e kulturës perëndimore – gjithçka që është e mirë, progresive, dhe inovative zë fill vetëm në Europë – por ai gjithashtu sheh në atë paketë një zbatueshmëri universale: nuk është karakteristike dhe e kufizuar në Europë, por është përhapur në shekullin e njëzetë për të përfshirë të gjithë globin mbarë.

Po të shkojmë pak më thellë, thonë kritikët, këndvështrimet eurocentrike të botës e shohin Europën si e vetmja formëdhënëse aktive e historisë botërore, gurra zanafillore në qoftë se doni të quani kështu. Europa vepron, pjesa tjetër e botës përgjigjet. Europa ka “agjensi”, apo vullnet veprimi, pjesa tjetër e botës është pasive. Europa bën historinë, pjesa tjetër e botës nuk ka asnjë histori derisa ajo hyn në kontakt me Europën. Europa është qendra, pjesa tjetër e botës është periferia. Vetëm europianët janë të aftë që të iniciojnë ndryshimin apo modernizimin, pjesa tjetër e botës jo.

Në një nivel më të thellë, sipas kritikëve, eurocentrizmi nuk është thjesht një besim në epërsinë e kaluar apo të tashme të Europës, por është “një çështje e ... punës akademike”<sup>[13]</sup> (pra, e faktit të “rrënjësor”). Nuk është një “prirje, por një mënyrë e të përcaktuarit çfarë është e vërtetë dhe çfarë është e rreme. Në këtë masë, eurocentrizmi është një mënyrë e të njohurit që përcakton kriteret për atë që ushtruesit e tij e cilësojnë se janë “faktet”. Në këtë mënyrë, eurocentrizmi është një *paradigmë*,

një set supozimesh në lidhje me atë se si funksionon bota, që gjeneron pyetje të cilave më pas mund t'u jepen përgjigje duke zbuluar “faktet”.[14]

Në fund, idetë eurocentrike në lidhje me botën dhe se si ajo filloi të ishte ashtu siç është mbahen thellësisht si të vërteta nga amerikanët. Dhe vërtet, historia amerikane shpesh paraqitet si kulmi, shprehja më e kulluar dhe më e mirë, e civilizimit perëndimor. Europeanët dhe madje edhe historia botërore paraqiten mjaft shpesh nga një këndvështrim eurocentrik, pavarësisht nëse studentët apo stafi akademikë janë të ndërgjegjshëm për këtë. Kryesisht ai supozohet se është “i vërtetë”. Situata është njëloj si ajo me të cilën përballlet Keanu O’Reeves në filmin *The Matrix (Matrica)*, apo Jim Carrey në *The Truman Show*. Ata që janë brenda, në të vërtetë, nuk kanë një mënyrë të pavarur për të mësuar në qoftë se janë brenda një matrice apo një studioje televizive të inskenuar nëse nuk e vështrojnë atë nga jashtë. Mbledhja e më tepër fakteve nuk do të ishte e mjaftueshme, duke qenë se të gjitha faktet nga brenda kanë prirjen që të konfirmojnë realitetin dhe të vërtetën, matricës brenda së cilës është një njeri. Disa fakte që janë grumbulluar mund të mos përshtaten me të tërën, por kryesisht ato thjesht shpërfillen ose injorohen sikur të ishin anomali – aksidente, në qoftë se ju pëlqen. E njëjta gjë është e vërtetë për eurocentrizmin. Në qoftë se idetë eurocentrike, në qoftë se ngritja e Perëndimit, janë të gabuara, si mund ta dimë ne një gjë të tillë? Mënyra për ta ditur këtë është duke dalë jashtë asaj mënyre të të shpjeguarit se si bota u bë kështu siç është dhe duke menduar në lidhje me mënyra të tjera të të kuptuarit të ndryshimeve të mëdha që i kanë dhënë trajtë botës sonë.

Lexuesit ka të ngjarë të nuhasin një paradoks këtu. Në njërin krah, unë fillova duke vënë në dukje se tiparet kyçe të botës moderne janë europiane në origjinë, dhe se unë mendoj që një qasje historike mund të shpjegojë se si dhe përse industria, shteti komb, dhe hendeku ndërmjet të pasurve dhe të varfërve e përkufizojnë botën tonë. Në krahun tjetër, unë sapo i kam refuzuar shpjegimet e zakonshme eurocentrike të origjinës së botës moderne. Si mund të ketë vallë një shpjegim jo-eurocentrik të një bote që ka tipare europiane? Shkurtimisht, ne mund ta bëjmë këtë duke zgjeruar rrëfimin për të përfshirë pjesë të botës që deri më tani kanë qenë të përjashtuara ose kanë qenë të pavëna re – ne mund ta fillojmë dhe përfundojmë këtë histori gjetiu.[15] Kur ne ta bëjmë këtë, ne do të shohim se vetëm një narrativë e re globale – jo e qendërzuar mbi Europën – do të mjaftojë për të shpjeguar fillësat e botës moderne.

## **Narrativat historike dhe rrëfimet**

Për historianët, sendërtimi i një narrative – një historie me një fillim, një mes dhe një fund – është kyç për atë se si ne e dimë atë që dimë, se si ne përcaktojmë atë që është e vërtetë në lidhje me të shkuarën.[16] Ngritja e perëndimit është një rrëfim – sigurisht, një rrëfim në thelbin e Eurcentrizmit – që ofron kriteret për përzgjedhjen e saj që është dhe që nuk është relevante për atë rrëfim. Por për shkak se ngritja e Perëndimit i jep trajtë të gjithë punës akademike historike që është përmendur më sipër, ajo është më tepër se sa thjesht një histori apo narrativë e zakonshme; ajo është një “narrativë qendrore (narrative madhore), “një skemë e madhe për organizimin e interpretimit dhe shkrimit të historisë,” “rrëfime gjithëpërfshirëse në lidhje me origjinat,” sikundër e kanë thënë historianët Appleby, Hunt, dhe Jacob.[17]

Kështu që, e vetmja mënyrë për të përcaktuar në qoftë se ngritja e Perëndimit është e gabuar është që të sendërtohet një narrativë alternative se si bota u bë ajo që është: ne duhet të dalim jashtë matricës së quajtur “ngritja-e-Perëndimit”. Po ta bëjmë këtë, ne do të arrijmë tre gjëra. Së pari, kjo do të ofrojë



një mënyrë të pavarur për të thënë se cilat pjesë, në qoftë se ka një të tillë, të paradigmës së ngritjes së Perëndimit mund të mbahen dhe cila ka nevojë që të hidhet poshtë. Së dyti, kjo do të ndihmojë lexuesit që të shqyrtojnë me kritikizëm supozimet e tyre në lidhje me atë se si funksionon bota. Dhe së treti, kjo do të ngrejë çështjen më të përgjithshme të asaj se si në e dimë atë që ne dimë në lidhje me botën dhe historinë e saj. Kjo është detyra e kësaj historie të shkurtër. Në pjesën e mbetur të kësaj parathënieje, unë dëshiroj që të skicoj elementët e kësaj narrative alternative.

Fillimisht unë kam nevojë që të bëjë një paraqitje të tre koncepteve shtesë: ato të kontingjencës historike, të aksidencës historike, dhe të konjunkturës/ndërlidhjes historike. Ia fillojmë me idenë e *kontingjencës*. Një implikim mjaft i fuqishëm i rrëfimit të ngritjes së Perëndimit, ndonëse rrallëherë paraqitet shprehimisht, është bindja se mënyra se si bota u zhvillua ishte e vetmja mënyrë e mundshme. Për shkak të avantazheve historike që evropianët gëzonin, me gjasë që nga rënia e Perandorisë Romake apo madje edhe që nga grekët lashtë apo gjenetika europiane, ky interpretim nënkupton se ngritja e Perëndimit ishte e *pashmangshme*. Mund t'i jenë dashur disa ulje e ngritje, por herët a vonë Perëndimi do të ngrihej mbi të gjitha pjesët e tjera të botës.

Ndonëse ne do të na duhet gjithashtu që të trajtojmë dominancën politike, ekonomike dhe ushtarake të Europës dhe degëzimeve të saj (p.sh., Shtetet e Bashkuara) për 200 vitet e fundit, nuk ka asnjë arsye që të mendojmë se kjo dominancë ishte e pashmangshme, apo, se kjo dominancë do të vijojë më tutje. Dhe vërtet, ajo shfaqet e pashmangshme vetëm sepse ky rrëfim është i qendëruar mbi Europën. Por sapo adoptohet një perspektivë më e gjerë globale, dominanca e Perëndimit jo vetëm që ndodh më vonë në kohë, ka të ngjarë vonë, në vitet 1750-1800 dhe ndoshta jo deri në fillimin e shekullit të nëntëmbdhjetë, por ajo gjithashtu bëhet më e qartë se ajo ishte *kontingjente* nga zhvillimet tjera që ndodhën në mënyrë të pavarur gjetiu në botë.

Më e rëndësishmja, motori ekonomik që shtyn ekonominë globale – dhe bashkë me të edhe shkëmbimin e ideve, të korrat e reja të ushqimeve, dhe të mirat e prodhuara – ishte në Azi. Me gjasë, që në vitin 1000 e.s., rritja ekonomike dhe e popullsisë e Kinës stimuloi të gjithë kontinentin Euroaziatik; një tjetër dallgë erdhi mbas vitit 1400 dhe zgjati deri diku në vitin 1800. Azia ishte burimi i një kërkese të stërmadhe për argjend për të mbajtur ekonominë e Kinës dhe Indisë në rritje dhe gjithashtu dhe burimi më i madh i të mirave të prodhuara (sidomos tekstileve dhe porcelanit) dhe erëzave. Gjithashtu, mjaft domethënëse në narrativën tonë ka për të qenë fillimi i Islamit dhe zgjerimi, nga shekulli i shtatë deri në shekullin e shtatëmbdhjetë, i perandrive islame në drejtimin e perëndimit në brendësi të Detit Mesdhe dhe në drejtimin e lindjes deri në Oqeanin Indian dhe deri në Indonezi. Atje ku Azia tërhoqi vëmendjen dhe interesin e tregtarëve nga e gjithë Eurazia, perandoria islame bllokoi aksesin e drejtëpërdrejtë evropianë në pasuritë e Azisë, duke stimuluar një dëshirë në mesin e evropianëve për të gjetur itinerare të reja detare drejt Oqeanit Indian dhe Kinës.

Madje edhe “zbulimi” që Kolombi i bëri Amerikave dhe lundrimi i Vasko de Gamës përreth Afrikës për të shkuar në Oqeanin Indian nuk do të kishin bërë shumë për fatet europiane në qoftë se ata nuk do të kishin gjetur sasi të mëdha argjendi në Botën e Re me të cilat të blinin mallrat aziatike dhe një hambar të skllevërve afrikanë për të punuar në plantacionet e Botës së Re mbasi sëmundjet europiane vranë pjesën më të madhe të popullsisë indigjene amerikane. Sikundër kemi për ta parë, krijimi i institucioneve dhe burimeve të pasurisë dhe pushtetit në disa pak pjesë të avancuara të Europës, duke u mundësuar këtyre zonave që të vendosin një dominancë mbi pjesën tjetër të botës, ishte *kontingjente* mbi këto zhvillime, dhe të tjera si këto.

Madje në vitin e vonë 1750, teksa pjesë të Europës iu afruan niveleve të zhvillimit të arritura në zona kyçe të Azisë, të gjitha këto pjesë mjaft të zhvilluara të Eurazisë – Europa si edhe Azia – filluan të pozicionoheshin kundër limiteve mjedisore të rritjes së mëtejshme, me përjashtim të Anglisë, ku depozitat e qymyrit lehtësisht të aksesueshme u mundësuan britanikëve që të largoheshin nga kufizimet nëpërmjet industrializimit të bazuar mbi burimet e reja të fuqisë së avullit. Në vitet 1800, ky burim i ri fuqia u vu në përdorim ushtarak, dhe më pas – dhe vetëm më pas – peshorja filloi të anonte kundër aziatikëve, dhe vetëm atëherë europianët, të udhëhequr fillimisht nga britanikët, ia arritën që të lëviznin drejt vendosjes së dominancës së qartë globale. Argumenti është se ngritja e Perëndimit nuk ishte e pashmangshme, por ishte tej mase kontingjente, (d.m.th. jo e domosdoshme). Bota ku ne jetojmë mund të kishte qenë e ndryshme; nuk ka asgjë në të shkuarën – me përjashtim të rastit kur përdoret sendërtimit ngritja-e-Perëndimit – që të tregojë se bota duhej të bëhej një botë e dominuar nga institucionet perëndimore.

Krahas kësaj, në qoftë se ngritja e Perëndimit nuk ishte e pashmansghme por kontingjente, kjo do të thoshte se e ardhmja gjithashtu është kontingjente, dhe kjo është arsyeja përse ka rëndësi se cili është këndvështrimi ynë mbi të shkuarën. Në qoftë çdokush do e kishte të pamundur që të ndryshonte rezultatin e historisë me atë që ai do të bënte, atëherë asgjë që ne mund të bëjmë *tani* nuk mund t'i japë formë të ardhmes sonë: ne jemi të zënë në grackë në një stërhollim dhe zgjatim të asaj që ekziston në të tashmen, me përjashtim të rastit kur një aksident vigan na shtyn ne në një drejtim të ndryshëm. Në njërin krah, në qoftë se historia – dhe këndvështrimi që ne kemi për atë – është kontingjente, atëherë veprimet që ne ndërmarrim këtu dhe tani kanë vërtet të ngjarë që të ndryshojnë botën. Ne nuk jemi të zënë në grackë, por më saktë ne (dhe me ne dua të them të gjithë popujt e botës, jo thjesht amerikanët apo ata në Perëndim) mund të kemi agjensi. Në qoftë se e shkuara mund të kishte qenë e ndryshme, atëherë e tillë mund të jetë edhe e ardhmja. Të qenit “kontingjente”, nga krahu tjetër nuk do të thotë se dominanca europiane e botës për 200 vitet e fundit ishte një aksident, sepse kishte shkaqe për atë zhvillim, sikundër ka për të qartë ky libër.<sup>[18]</sup> (Kujtojmë se ky është fragment libri sh.p.)

Kjo nuk do të thotë se *aksidentet* historike nuk ndodhin, sepse ato ndodhin. Më lejoni të japë dy shembuj që më tutje gjatë librit do të diskutohen më gjerë. Në shoqëritë bujqësore, dhe e tillë ka qenë pjesa më e madhe e botës deri së voni, ndryshimet klimateruke mund të kenë një impakt madhor mbi madhësinë e të korrave, jo thjesht në një vit por përgjatë disa dekadave. Kushtetet më të favorshme mund të prodhojnë të korra më të mëdha, duke ulur çmimin e ushqimeve për këdo dhe duke nxitur rritjen e ekonomisë. Kushtet e varfëra, si ato që u shfaqën në pjesë të mëdha të botës gjtë “Epokës së Vogël të Akullnajave” të shekullit të shtatëmbëdhjetë, mund të vendosin ekonomi të tëra nën trysni të ashpër. Ndonëse ndryshimet klimaterike vërtet kanë shkaqe, nga këndvështrimi i historisë njerëzore, ato janë aksidente në kuptimin e dyfishtë të të qenit të paparashikueshme dhe përtej kontrollit njerëzor.

Një tjetër “aksident” është i rëndësishëm për rrëfimin e historisë së qymyrit dhe marrëdhënien e tij me industrializimin. Depozitat e qymyrit u krijuan qindra miliona vjet më parë, dhe fakti se përse u vunë në raport me vendin ku njerëzit jetojnë është pastërtisht aksidentale. Disa depozita qymyri dolën se ishin afër vendeve ku njerëzit edhe kishin nevojë për ato edhe dinin se si t'i përdornin ato, dhe disa ishin larg dhe, për pasojë, të papërdorshme. As hollandezët dhe as kinezët, për shembull, të cilët kishin aftësinë dhe nevojën për të zhvilluar një industri qymyrguri për furnizimet pme energji për të mbajtur në këmbë rritjen e tyre ekonomik, nuk kishin depozita qymyri në afërsi të zonave që u duheshin atyre. Kjo ishte njëra nga arsyet se përse rritja e tyre ekonomike në shekullin e tetëmbëdhjetë u ngadalësua,

ndërkohë që ajo e Britanisë, që thjesht ndodhi që “rrinte ulur” mbi depozita vigane, të afërta, lehtësisht të punueshme të qymyrit, u përshpejtua. Shpërndarja e depozitave të qymyrit është, pra, aksidentale për sa i përket historisë njerëzore, por pa dyshim ajo pati një impakt dramatik mbi atë se cilat vende u industrializuan dhe cilat jo.

Tjetra është ideja e “konjunkturës, apo ndërthurjes së ngjarjeve”. Një konjunkturë, apo ndërthurje ngjarjesh, ndodh kur disa zhvillimi përndryshe të pavarura bëhen bashkë në mënyra që ndërvperojnë njëra me tjetrën, duke krijuar një moment historik unik. Për qëllimet tona, një mënyrë për të menduar në lidhje me këtë është që të shqyrtohet bota sikur ka patur disa rajone që kanë qenë pak a shumë të pabrrura nga njëra tjetra, duke pasur kësajsoj historitë e tyre më vete. Në Kinë, për shembull, vendimi i fillimit të viteve 14000 nga qeveria për të përdorur argjendin si bazë për sistemin e tyre monetar lindi nga rrethanat që janë të veçanta për historinë kineze. Por ky vendim kinez kishte një impakt global në shekullin e gjashtëmbëdhjetë dhe atë të shtatëmbëdhjetë kur europianët zbuluan sasi të mëdha argjendi në Botën e Re dhe një kërkesë edhe më të madhe kineze për atë. Për pasojë, argjendi vërshoi në brendësi të Kinës (dhe Indisë), dhe mëndafshet, erëzat, dhe poercelanet aziatike vërshuan në Europë dhe Botën e Re, duke inauguruar epokën e parë të globalizimit. Kjo ishte një koniunkturë, apo ndërthurje ngjarjesh: gjëra që ndodhin në pjesë të ndryshme të botës për arsye që kanë të bëjnë me rrethanat lokale që më pas bëhen të një rëndësie globale.

Koniunkturat gjithashtu mund të ndodhin brenda një rajoni të dhënë kur disa zhvillime, që përndryshe janë të pavarura, arrijnë pikat kritike dhe ndëvprojnë njëra me tjetrën. Për shembull, zhvillimi i shteteve kombe si forma dominante e organizimit politik në Europë ndodhi për arsye mjaft të pavarura nga ato që çuan drejt industrializimit. Megjithatë, kur këto të dyja konvergjuan në shekullin e nëntëmbëdhjetë – u puqën për të prodhuar një koniunkturë – u zhvillua një forcë mjaft e fuqishme globale, sidomos kur këto të dyja ofruan bazën për epërsi ushtarake.

Vëmendja që ne i kushtojmë kontingjencës, aksidencës/rastësisë, dhe koniunkturës nënkupton se shpjegimi që ne i bëjmë zhvillimeve madhore në formimin e botës moderne do të përmbajë disa shkaqe, jo vetëm një. Shpjegimet njëshkakësore janë tejet të thjeshta për të marrë parasyh kompleksitetin e njerëzve, shoqërive, dhe ndryshimit historik. Ne, kësodore, nuk duhet të kërkojmë për *shkakun* e Revolucionit Industrial, sepse nuk ka një të tillë të vetëm. Më saktë, ne do të gjejmë një sërë faktorësh që janë mjaft të dobishëm për të shpjeguar Revolucionin Industrial. Them “të dobishëm” sepse ne duhet të lëmë hapur mundësinë që teksta mësojmë më tepër ose teksta perspektiva jonë ndryshon, ne mund të shohim mangësitë e shpjegimit të ofruar këtu.

Pra, narrativa e këtij libri në lidhje me atë se si bota moderne erdhi në ekzistencë – bota kapitalizmit industrial, një sistem i shteteve kombe dhe luftërave ndërshtetërore, dhe një hendek në rritje midis më të pasurve dhe më të varfërve në botën tonë – do të jetë një narrativë që ka kontingjencë, aksidencë/rastësi dhe koniunktura. Bota mund të ketë qenë një vend mjaft i ndryshëm. Deri rreth 200 vite më parë, mënyra më e suksesshme sipas të cilës njerëzit organizoheshin dhe promovonin rritjen e numrit të tyre ishte në perandori të mëdha të bazuara mbi tokën, të cilat ndodheshin në Azi, Afrikë, Lindjen e Mesme, dhe Amerikat. Por po të mos kishte qenë një seri kontingjencash, rastësishë dhe konjunkturash, ne mund të ishim ende duke jetuar në një botë të perandorive agrare.

Krahas një subjekti, megjithatë, një narrativë ka një fillim, një mes, dhe një fund, zgjedhjet e të cilave ndikojnë në mënyrë domethënëse mbi rrëfimin që po tregohet. Ne kemi zgjedhur ta fillojmë rrëfimin tonë me atë se ç’formë kishte bota moderne në vitin 1400. Arsyeja përse fillojmë në rreth vitit 1400

është se kjo periudhë është përpara rënies rreth e qark botës me anë të lundrimit në mesin e viteve 1500 dhe prandaj na lejon që ta shqyrtojmë botën dhe dinamikën e saj përpara herës së parë që një botë vërtet e lidhur globalisht të bëhej e mundur. Mesi i rrëfimit sillet rreth fillimit të Revolucionit Industrial në vitet 1750-1800 me një shpjegim të asaj se përse ngjarjet më vendimtare ndodhën fillimisht në Britani dhe jo gjetiu në botë. Në botimin e parë të librit (fragmenti është pjesë e botimit të dytë sh.p.), rrëfimi përfundonte përreth vitit 1900 për shkak se ajo është koha kur kapitalizmi industrial dhe shtetet kombe filluan të përpunoheshin plotësisht në një shkallë globale. Ky botim vijon rrëfimin deri në shekullin e njëzet.

Kjo narrativë e historisë botërore gjithashtu orvatet që të jetë një *narrativë jo-eurocentrike*, domethënë, të ofrojë një alternativë për subjektin e zhvilluar përreth narrativës kryesore ekzistuese të ngritjes së Perëndimit. Por a ka rëndësi kjo? Përse duhet të shqetësohemi fort për sendërtimin e një narrative të re, jo-eurocentrike rreth formimit të botës moderne? Kjo pyetje mund të marrë përgjigje në një numër rrafshesh. Së pari, rrëfimi i përgjithshëm i ngritjes së Perëndimit mund të të jetë çorientues ose i gabuar në mënyra fundamentale, ndonëse pjesë të tij mund të jetë të sakta. Për shembull, njëra nga përgjigjet më të fuqishme të kohëve të fundit ndaj pyetjes se çgarë e shkaktoi “mrekullinë europiane” ka të bëjë me familjet dhe numrin e fëmijëve që çdo familje kishte. Argumenti është pak a shumë i tillë: Mbas Vdekjes së Zezë (Murtaja) të mesit të shekullit të katërbëdhjetë, trysni të ndryshme ekonomike dhe mjedisore i nxitën familjet europiane që të martoheshin vonë, duke reduktuar në këtë mënyrë madhësinë e familjes. Pasja e më pak fëmijëve nënkuptonte që familjet fermere mund të fillonin të grumbullonin kapital, duke e dërguar kështu Europën në rrugën e saj drejt një “revolucioni prodhimtar”. “Nëpërmjet të vonuarit të martesës,” sipas një historie të kohëve të fundit, “fshatarët europianë përcaktuan një kurs që i ndau ata nga pjesa tjetër e banorëve të botës.”<sup>[19]</sup>

Ndonëse mund të jetë e vërtetë se fshatarët e Europës Perëndimore u sollën në atë mënyrë, duke e çliruar veten nga “modelet instiktive të sjelljes” (pra, sjellja në jetë e parregulluar e fëmijëve) që supozohej se dënonte popujt e tjerë me mbipopullim dhe varfëri, thjesht nuk është e vërtetë se fshatarët europianë ishin unik në këtë sjellje. Një punim i kohëve të fundit mbi Kinën tregon se familjet rurale edhe atje gjithashtu – dhe ndoshta për shumë më gjatë – e kufizuan madhësinë e familjes, ndonëse metodat e përdorura ndryshonin.<sup>[20]</sup> Vetëm me këtë shembull, është hequr një patericë nga poshtë pretendimit të unikalitetit të europianëve dhe arsyeve për “ngritjen” e tyre. Dhe vërtet, akademikët dhe studiuesit kanë treguar së fundmi se praktikisht që çdo faktor që mbështetësit e tij e kanë identifikuar me “mrekullinë europiane” mund të gjendet në vise të tjera të botës;<sup>[21]</sup> domethënë, ato *nuk* ishin unike për Europën, dhe prandaj nuk mund të evokohen për të shpjeguar ngritjen e Perëndimit.

Kjo narrativë është gjithashtu jo-eurocentrike për shkak se shumëçka prej saj do t'i kushtohet tregimit të mënyrave në të cilat pjesë të tjera të botës ishin ose më të avancuara ose të paktën të barabarta me pjesët më të zhvilluara të Europës, përgjatë shumë shekujve, së paku deri rreth vitit 1800. Ky libër nuk do të mund të ishte shkruar pa sasinë e madhe të punës studimore të botuar në anglisht mbi Azinë, Afrikën, dhe Amerikën Latine, që ofron bazën për një narrativë jo-eurocentrike. Ne, kësisoj, jemi fatlumë që të mos jemi më të varur për të kuptuarit tonë të botës mbi rastësinë që shumë prej asaj që është shkruar gjatë 200 viteve të fundit ka qenë nga dhe për europianët që eksplorojnë vetë historinë e tyre. Sikundër e ka thënë një kritik, deri së voni historianët kanë qenë si ai i dehuri nën dritat e rrugës që përpiqet të gjejë çelësat e humbura të makinës: kur një oficer policie e pyet përse po kërkon aty, ai i thotë: “Sepse këtu ka dritë!” Fatmirësisht, akademikët dhe studiuesit së fundi kanë filluar të hedhin mjaft dritë mbi pjesë të tjera të botës, kështu që ne nuk kemi përse të ecim kuturu nëpër errërisë. Sot

ne dimë mjaftueshëm për pjesën tjetër të botës për të vënë në diskutim narrativën qendrore të ngritjes së Perëndimit dhe të fillojmë të sendërtojmë një narrativë tjetër jo-eurocentrike.

Në qoftë se koncepti i ngritjes së Perëndimit nuk mund të shpjegojë në mënyrë adekuate përse Perëndimi dhe institucionet e tij u bënë forca dominante në botë gjatë dyqind viteve të shkuara, e akoma më pak ngritjen e qëndrueshme të Azisë Lindore gjatë katër dekadave të fundit,<sup>[22]</sup> atëherë përdorimi i vazhdueshëm i saj vërtet përjetëson një mit. Disa mitologji mund të jenë fare mirë të padëmshme, të paktën kur ato pranohen si të tilla, si në rastin kur në rrëfimet greke apo indigjene amerikane në lidhje me yjësitë na duken joshëse. Por kur një mitologji përjetëson idenë se një grup njerëzish është superior, ka qenë për shekuj në mos për mijëvjeçarë, dhe se gjithë të tjerët janë kësodore inferiorë në një mori mënyrash, siç ndodh me idetë e qenësishme të ngritjes së Perëndimit, atëherë mitologjia ushtron dhunë ndaj të tjerëve dhe duhet të braktiset në tërësi.

### **Elementët e një narrative jo-eurocentrike**

Së pari, ne duhet të marrim të gjithë botën si njësinë tonë të analizës, dhe jo vende të veçanta apo madje edhe rajone (p.sh., “Europa”, “Azia Lindore”).<sup>[23]</sup> Ne do të kemi mundësinë që të diskutojmë zhvillimet në vende dhe perandori të veçanta, por gjithnjë në një kontekst global. Për shembull, ne do të shohim se ndërkohë që Revolucioni Industrial nisi në Britani (dhe madje vetëm pjesërisht atje), kjo nuk ndodhi për shkak të guximit, aftësisë shpikëse, apo politikës angeleze, por më saktë për shkak të zhvillimeve globale që përfshinin Indinë, Kinën, dhe kolonitë e Botës së Re. Me fjalë të tjera, Revolucioni Industrial ishte historikisht kontingjent mbi forca globale.

Megjithatë, marrja e një perspektive globale nuk nënkupton se bota ka qenë gjithnjë një dhe e ndërlidhur me një qendër të vetme nga e cila zhvillimi dhe progresi janë përhapur drejt rajoneve më pak të zhvilluara. Më saktë, ka më tepër sens po ta mendojmë botën në vitin 1400 sikur ajo ka qenë e përbërë nga disa sisteme rajonale, ose me fjalë të tjera ka qenë “policentrike”,<sup>[24]</sup> secili me bërthama dendësisht të populluara dhe industrialisht të avancuara të furnizuara nga periferitë e tyre. Ndonëse shkëmbimet tregtare dhe kulturore vërtet nënkuptonin se pjesa më e madhe e rajoneve të botës ndërvepronin, ose mbivendoseshin, në margjina (me përjashtim të sistemeve rajonale në Amerika, të cilat ndërvepronin me njëri tjetrin, por jo me Eurazi-Afrikën deri në vitin 1492), ajo që ndodhi në këto rajone ishte më tepër një rezultat i dinamikave që ishin specifike për atë vend.

Supozimi se bota në vitin 1400 ishte policentrike dhe pjesë të mëdha të Eurazisë ishin gjerësisht të krahasueshme në terma të niveleve të zhvillimit na ndihmon që të kuptojmë se si një botë akoma dhe më tepër e integruar erdhi në jetë, dhe se si dhe përse perëndimorët përfundimisht e dominuan atë. Nënkuptimi i modelit eurocentrik është se zhvillimi dhe progresi zunë fill në Europë dhe u përhapën nga andej për të kapluar pjesën tjetër të botës: europianët vepruan, dhe pjesa tjetër e botës ishte pasive ose në vendnumëro (derisa u shtrëgnuan që të reagonin ndaj Europës).<sup>[25]</sup>

Në këtë narrativë, në kundërdallim, ne do të shohim se Kina dhe India në veçanti luajnë role domethënëse, dhe se ne nuk mund të kuptojmë se si dhe përse bota u bë kështu siç është pa kuptuar zhvillimet në Azi. Ne do të mësojmë se si dhe përse Kina zhvilloi një oreks kaq të madh për argjend sa që krijoi një kërkesë globale, duke tërhequr argjend nga rreth e qark botës drejt Kinës dhe duke e përmbytur tregun botëror me prodhime kineze. Ne do të hetojmë gjithashtu edhe mallra të tjerë dhe ofertën e kërkesën e tyre globale gjithashtu, sidomos për sheqerin, skllëverit (fatkeqësisht, qeniet

njerëzore ishin mallra), dhe tekstilet e pambukut, ku të gjitha ishin të prodhuara fillimisht (dhe të prodhuara me më tepër efikasitet) në pjesë të botës të ndryshme nga Europa.

Ky libër do të theksojë kontingjencat dhe konjunkturat historike; Kinën dhe Indinë; dhe argjendin, sheqerin, skilevërit, dhe pambukun teksa ne zhvillojmë një tablo jo-eurocentrike të asaj se si bota u bë kjo që është sot.

Shënime

[1] "Statement of the Group of Seven Leaders," July 20, 2001 ([www.usinfo.state.gov/admin/004/](http://www.usinfo.state.gov/admin/004/)). Vendet e G7 janë Kanadaja, Franca, Gjermania, Italia, Japonia, Mbretëria e Bashkuar, dhe Shtetet e Bashkuara. Rusia u ftua që t'i bashkohej G7 në 1998, kështu që ndonjëherë quhet "G8," ose "G7 plus Russia."

[2] Shiko Draft Programin e Forumit Publik të Gjenovës ([www.genoa-g8.org/gpf-eng.htm](http://www.genoa-g8.org/gpf-eng.htm)).

[3] Karl Marx dhe Friedrich Engels, *The Communist Manifesto* (New York: Washington Square Press, 1964), 64–65.

[4] Philip D. Curtin e ka përkufizuar "modernizimin" si shtysa për të arritur produktivitet të lartë ekonomik dhe nivele të larta konsumi, pavarësisht nga diferencat kulturore. *The World and the West: The European Challenge and the Overseas Response in the Age of Empire* (Cambridge: Cambridge University Press, 2000), 110. Megjithatë, teoricienët e "modernizimit" të pas-Luftës së Dytë Botërore, të viteve 1950 dhe 1960, zhvilluan një listë të asaj që donte të thonte të ishte "modern" që dukej mjaft e ngjashme me Shtetet e Bashkuara.

[5] Termi është marrë nga një libër nga E. L. Jones, *The European Miracle* (Cambridge: Cambridge University Press, 1981).

[6] Sidomos historiani ekonomik britanik Patrick O'Brien. Shiko artikullin e tij "European Economic Development: The Contribution of the Periphery," *Economic History Review*, 2d ser., 35 (1982): 1–18.

[7] Si shembuj të këtyre tezave të ndryshme shiko David S. Landes, *The Wealth and Poverty of Nations: Why Some Are So Rich and Some So Poor* (New York: W. W. Norton, 1998) dhe *The Unbound Prometheus: Technological Change and Industrial Development in Western Europe from 1750 to the Present* (Cambridge: Cambridge University Press, 1969); Lynn White, Jr., *Medieval Religion and Technology: Collected Essays* (Berkeley: University of California Press, 1978); Alfred Crosby, *The Measure of Reality: Quantification and Western Society, 1250–1600* (Cambridge: Cambridge University Press, 1997); Geoffrey Parker, *The Military Revolution: Military Innovation and the Rise of the West 1500–1800*, 2d ed. (Cambridge: Cambridge University Press, 1999).

[8] Siç u shpreh Presidenti amerikan George W. Bush, tregtia e lirë ndërkombëtare është "një domosdoshmëri morale" që do të "ndërtojë lirinë në botë, progress në hemisferën tonë dhe prosperitetet jetëgjatë në Shtetet e Bashkuara." Cituar në *New York Times*, 8 maj, 2001, p. A7.

[9] Për një konspekt të tre librave të fundit mbi këtë temë shiko David D. Buck, "Was It Pluck or Luck that Made the West Grow Rich?" *Journal of World History* (Fall 2000): 413–430.

[10] J. M. Blaut, *The Colonizer's Model of the World: Geographic Diffusionism and Eurocentric History*

(New York: Guilford Press, 1993), 1.

[11] Samir Amin, *Eurocentrism* (New York: Monthly Review Press, 1989), vii.

[12] Andre Gunder Frank, *ReOrient: Global Economy in the Asian Age* (Berkeley: University of California Press, 1998), 32.

[13] Blaut, *The Colonizer's Model of the World*, 8–9.

[14] Ideja e paradigmes shkencore dhe eksplorimit të konditave nën të cilat ato mund të ndryshojnë u zhvillua për herë të parë nga Thomas Kuhn në një vepër klasike, *The Structure of Scientific Revolutions*, botim i dytë i zgjeruar (Chicago: University of Chicago Press, 1970). Shembulli parësor i Kuhn ishte revolucioni kopernikas, domethënë, ndryshimi nga një këndvështrim i sistemit diellor me tokën në qendër (këndvështrimi i mbrojtur nga Kisha Katolike), në një me diellin në qendër. Ndonëse Kuhn diskutoi “paradigmat” dhe spostimet paradigmatiche vetëm sa i përket shkencës, ideja është zgjeruar edhe në mënyrën se si funksionojnë shkencat sociale.

[15] Disa mund të kundërshtojnë se ndonëse kjo qasje mbetet e zhytur në eurocentrizëm për shkak të disa supozimeve të pashqyrtuara në lidhje me vetë konceptet që përdoren, objektet që identifikohen se kanë nevojë për shpjegim, dhe madje edhe historia si metodë, ku ka nga ata që pretendojnë se janë të gjitha në mënyrë implicite eurocentrike. Për shembull, disa kanë pyetur në qoftë se shtetet dhe kapitalizmi industrial janë vërtetë kaq të rëndësishme sa të shpjegohen, siç janë vetë konceptet e vetes, trupit, seksualitetit, vendit, shkakësisë, dhe historisë, dhe ata kanë propozuar metodologji të reja “postmoderne” të “dekonstruksionit” apo “komuniteteve të diskursit” dhe “gjuhën e tyre të privilegjuar”, që jep “pushtet”, për t'i eksploruar ato. Kjo është një temë jashtëzakonisht e ndërlikuar, por ata që dëshirojnë të lexojnë një parathënie të mirë mund të fillojnë me Joyce Appleby, Lynn Hunt, and Margaret Jacob, *Telling the Truth about History* (New York: W. W. Norton, 1994).

[16] Jo të gjitha historitë janë “të vërteta”. Disa janë të shpikura nga autorët: ato janë trillim (si librat Harry Potter apo Tre Arinjtë). Ndërkohë që edhe historia dhe fikcioni zhvillojnë rrëfim, ajo që e dallon historinë nga fikcioni është se faktet historike janë të vërteta. Historianët kanë zhvilluar mjete dhe metoda të sofistikuar për shkrimin e narrativave historike (pra, histori që janë “të vërteta”). Megjithatë, sikundër tregon diskutimi vijues i “narrativës qendrore”, ideja e të vërtetës historike është e ndërlikuar dhe nuk mund të reduktohet thjesht në atë që është e vërtetë dhe e rreme, por duhet të përfshijë një shqyrtim të asaj se si ne përcaktojmë kriteret për të vendosur atë që është e vërtetë dhatë që nuk është.

[17] Appleby, Hunt, and Jacob, *Telling the Truth about History*, 232.

[18] Për një diskutim të përmbledhur të determinizmit dhe rastësisë në histori, shiko E. H. Carr, *What Is History?* (New York: Vintage Books, 1961), kapitulli 4.

[19] George Huppert, *After the Black Death: A Social History of Modern Europe*, botimi i dytë (Bloomington: Indiana University Press, 1998), 13.

[20] James Z. Lee dhe Wang Feng, *One Quarter of Humanity: Malthusian Myths and Chinese Realities* (Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1999).

[21] Shiko veprat nga Blaut, *The Colonizer's Model of the World*; Jack Goody, *The East in the West* (Cambridge: Cambridge University Press, 1996); Frank, *ReOrient*; R. Bin Wong, *China Transformed: Historical Change and the Limits of European Experience* (Ithaca, N.Y.: Cornell University Press, 1997); Kenneth Pomeranz, *The Great Divergence: China, Europe, and the Making of the Modern World Economy* (Princeton, N.J.: Princeton University Press, 2000).

[22] Shiko Giovanni Arrighi, Takeshi Hamashita, dhe Mark Selden, editorë *The Resurgence of East Asia: 500, 150, and 50 Year Perspectives* (New York: Routledge, 2003).

[23] Fernand Braudel është më i rëndësishmi nga historianët e kohëve të fundit që ka marrë një qasje globale në përpjekjen për të shpjeguar të paktën një pjesë të mrekullisë europiane, kapitalizmin. Libri i tij me tre vëllime *Civilization and Capitalism 15th–18th Century* (New York: Harper and Row, 1979–1984) është një tur intelektual në të cilin ai argumenton se ndërkohë që shumë pjesë të botës zhvilluan ekonomi tregu mjaft të sofistikuar, pak shkuan deri aty sa të zhvillonin kapitalizëm të vërtetë, dhe ai lulëzoi vetëm në Europë. Braudel ofron një argument interesant duke thënë se kapitalistët nuk ishin aspak të interesuar në tregjet e lira dhe konkurrencën e hapur, por më saktë punuan që të siguronin koncesione monopoli nga monarkët europianë: në ato rrethana karakteristike, kapitalizmi u rrit me shpejtësi në serrën europiane. Ne do të kemi mundësinë në kapitujt e mëvonshëm që të shqyrtojmë idetë e Braudel më në imtësi.

[24] Shiko Pomeranz, *The Great Divergence*, kapitulli 1. Pyetja nëse bota ka qenë një sistem i vetëm i integruar, dhe në qoftë se ka qenë e tillë, kur u bë ajo fillimisht një sistem i vetëm është një pyetje interesante që do të trajtohet më tepër në kapitujt që vijojnë. Mjafton të themi këtu se ka të paktën tre pozicione themelore. Njëlloj si Karl Marksi dhe Adam Smithi, Immanuel Wallerstein (*The Modern World-System*, 3 vëllime [New York: Academic Press, 1974–1989]), dhe J. M. Blaut (*The Colonizer's Model of the World*) e marrin periudhën 1492–1500 si koha e krijimit të një sistemi të vetëm botëror; Janet Abu-Lughod (*Before European Hegemony: The World System A.D. 1250–1350* [New York: Oxford University Press, 1989]) ka paraqitur prova të forta se një sistem botëror ka ekzistuar në vitet 1250-1350, i cili u shpërbë përpara themelimit të sistemit botëror modern; dhe Andre Gunder Frank dhe Barry Gillis kanë argumentuar për një histori 5,000 vjeçare të një sistemi botëror të vetëm ("The Five Thousand Year World System: An Introduction," *Humbolt Journal of Social Relations* 17, no. 1 [1992]: 1–79).

[25] Duhet vënë në dukje se ky model është njëloj i përbashkët për marksistët dhe për kampionet e kapitalizmit, kështu që unë nuk po propozoj që të zhvillojë një narrativë marksiste të formimit të botës moderne si një alternativë për një ngirtje kremtuese të Perëndimit; kjo është bërë tashmë, dhe disa herë madje. Shiko, për shembull, Eric J. Hobsbawm, seria me katër vëllime përfshirë *The Age of Revolution*, *The Age of Capital*, *The Age of Empire*, dhe *The Age of Extremes*, të gjitha të botuara (New York: Vintage, 1994–1996) dhe punimi i ndikuar nga marksizmi, libri i Wallerstein, *The Modern World System*.

#### **Date Created**

17/03/2019

#### **Author**

erasmusi